



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, më 6 dhjetor Trupi Gjykes I caktoi të premten, 16 dhjetor në orën 9:00 për shpalljen e aktgjykimit, saktësisht tre muaj pas mbylljes së çështjes.

Publiku mund ta përcjellë seancën në tri gjuhët e gjykatës, në shqipe, serbishte ose anglishte përmes faqes zyrtare të internetit, me vonesë, ose nga galeria e publikut. Ju lutem mbani parasysh se nevojitet regjistrim paraprak për të ndjekur seancën nga galeria e publikut. Në rast se dëshironi të regjistroheni paraprakisht, jeni të lutur të dërgoni një mesazh elektronik (email) në adresën: PUBLIC@scp-ks.org.

Më 1 dhe 2 dhjetor, Dhoma e Gjykatës së Apelit mbajti seancën e apelit në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*. Gjatë seancës, Mbrojtja dhe Prokuroria paraqitën argumentet e tyre dhe po ashtu Panelit të Apelit iu drejtuan edhe z. Gucati dhe z. Haradinaj. Paneli i Gjykatës së Apelit do të nxjerrë aktgjykimin në këtë çështje gjyqësore në kohën e duhur.

Informimi për median javën e ardhshme do të mbahet të premten, më 16 dhjetor pas shpalljes së aktgjykimit në çështjen gjyqësore *Mustafa*. Për orarin e saktë do t'ju njoftojmë në rubrikën *Aktuale* në faqen e internetit.

Informimi javor për median i javës së ardhshme do të jetë dhe informimi i fundit javor për këtë vit pasi javën pasardhëse fillon pushimi i gjykatës. Gjykata do të jetë e hapur gjatë periudhës së pushimit të gjykatës dhe puna do të vijojë si zakonisht në të gjitha njësitë e DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

